



THIRRJE PËR ABSTRAKT/PUNIM

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”,
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE,
DEPARTAMENTI I INFERMIERISTIKËS**

Në bashkëpunim me

**UNIVERSITETIN E VLORËS “ISMAIL QEMALI”
UNIVERSITETIN E SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”
“URDHRIN E INFERMIERIT TË SHQIPËRISË”
UNIVERSITETIN E BARIT “ALDO MORO”
UNIVERSITETIN E L’AQUILAS**

Organizon

**“KNIS 2022-KONFERENCËN E VI-të NDËRKOMBËTARE
INFERMIERORE NË SPECIALITETE”**

**Kjo konferencë organizohet nën kujdesin e Rektorit të Universitetit të
Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

Prof.Dr. Skënder TOPI

Si edhe

Prof.as.dr. Shkëlqim HIDRI

Doc./Dr. Elona GAXHJA

Prof.Dr.Medi AGOLLI





Departamenti i Infermieristikës, Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, Departamentin e Infermierisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë, Department of Life, Health and Environmental Sciences, Universitetin e L’Aquila-s, dhe Universitetin e Barit “Aldo Moro”, Itali, ju fton të paraqisni abstraktin/punimin tuaj për **“KNIS 2022-KONFERENCA E VI-të NDËRKOMBËTARE INFERMIERORE NË SPECIALITETE”** e cila do të zhvillohet në datat 19-20 maj 2022, në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan.

Këshilli Ndërkombëtar i Infermierëve ka shpallur si temë për Ditën Ndërkombëtare të Infermierëve për vitin 2022, **“INFERMIERËT: NJË ZË PËR TË UDHËHEQUR - INVESTONI NË INFERMIERI DHE RESPEKTONI TË DREJTAT PËR TË SIGURUAR SHËNDETIN GLOBAL”**, duke u fokusuar në nevojën për mbrojtje, mbështetje dhe investime në Infermieristikë, me qëllimin e forcimit të sistemit shëndetësor në mbarë botën.

Me këtë qëllim, kjo konferencë synon të bëjë bashkë akademikë, profesionistë, kërkues dhe studentë nga të gjitha fushat e shëndetit dhe disiplinat përkatëse si në: edukim infermieror, telemjekesi, sëmundje infektive, neonatologji, kirurgji, urgjencë, menaxhim i dhimbjes, psikiatri, trauma, pediatri, geriatri, shëndet publik, mami, kujdes kritik, politika shëndetësore, mjekësi ligjore, psikologji, shëndet mendor, shëndet paljativ, çështje etike, menaxhim dhe leadership, etj. duke i ftuar të kontribuojnë në zhvillimin e saj përmes dorëzimit të abstrakteve/punimeve të tyre me natyrë kërkimore, për të paraqitur dhe diskutuar risitë, tendencat dhe shqetësimet më të fundit, sfidat praktike të hasura dhe zgjidhjet e mundshme.

Ftohen hulumtues të fushës së Infermierisë, Mamisë, Mjekësisë, Teknikë laborantë, Teknik Imazherie, Farmakologjisë dhe Psikologjisë të marrin pjesë dhe të ndajnë dijet, perspektivat dhe zhvillimet e fundit shkencore në fushat përkatëse.



Data të rëndësishme:

Dorëzimi i Abstraktit/punimi i plotë: 7 prill 2022

Njoftimi i Pranimit/Refuzimit: 14 prill 2022

Data e Konferencës: 19-20 maj 2022

Vendi: Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Elbasan.

Gjuha e preferuar: Shqip, anglisht, italisht.

Cv-të e pjesmarrësve: Të gjithë abstraktet/punimet e dorëzuar duhet të kenë bashkangjitur dhe Cv-në e autorit të parë.

Kontakt:

Për çdo pyetje në lidhje me konferencën, ju lutem mos hezitoni të kontaktoni:	konferenca.fshmt@uniel.edu.al elona.gaxhja@uniel.edu.al
Për dorëzimin e abstrakteve, janë në dispozicion adresat:	konferenca.fshmt@uniel.edu.al armela.kapaj@uniel.edu.al

Informacion shtesë:

Për të dërguar abstraktin dhe punimin, për të komunikuar njoftimet për pjesëmarrjen, si dhe për çdo informacion të nevojshëm, luteni të shkruani në adresën elektronike të konferencës: konferenca.fshmt@uniel.edu.al. Më poshtë gjeni detajet për paraqitjen e abstraktit apo punimit tuaj, si edhe procesin e pranimit.

Faleminderit për interesin tuaj!



Udhëzimet për dorëzimin dhe pranimin e abstraktit/punimit

Abstraktet apo punimet duhet të jenë autentike (origjinale) dhe të një cilësie të lartë, nëpërmjet të cilave përshkruhen rezultate origjinale dhe të pabotuara të punës kërkimore konceptuale, konstruktive, empirike, eksperimentale ose teorike, në të gjitha fushat e infermierisë, shkencave mjekësore dhe të gjitha shkencave të shëndetit. Abstrakti/punimi që do të paraqisni nuk duhet të jetë prezantuar më parë në asnjë revistë, libër me ISBN apo çdo aktivitet tjetër shkencor.

Autorët duhet të paraqesin një abstrakt me 300-350 fjalë. Detajet e përshkrimit të secilit seksion të abstraktit përshkruhen më poshtë:

- ✚ Titulli i abstraktit/punimit: Duhet të jetë i qartë, i fortë dhe konciz. Sigurohuni që titulli i abstraktit tuaj të përshkruajë mirë argumentin, duke e informuar dhe tërhequr lexuesin për konceptin që do të diskutohet.
- ✚ Hyrja: Në hyrje të paraqitet një pasqyrë e studimit tuaj si edhe të nënvizohet qartë rëndësia e tij. Ky seksion mund të përforcohet me detaje nga përfundime të studimeve të mëparshme, duke evidentuar risinë që sjell studimi juaj në krahasim me to.
- ✚ Qëllimi i studimit: Ju duhet të përshkruani se cili është qëllimi i studimit tuaj.
- ✚ Metodat: Në këtë seksion ju duhet të paraqisni metodologjinë e kërkimit që keni përdorur për të mbledhur të dhënat tuaja, duke përfshirë përshkrimet e instrumenteve, softwerit ose pjesëmarrësve në studim.
- ✚ Rezultate: Përmbliidhni shkurtimisht rezultatet e studimit tuaj.
- ✚ Konkluzione: Bazuar në analizën e të dhënave tuaja, përshkruani cilat janë përfundimet e këtij studimi duke deklaruar implikimet teorike ose praktike të punimit tuaj dhe/ose përshkruani se si ky punim ka sjelle risi.
- ✚ Fjalë kyçe – Listoni në rend alfabetik 3-5 fjalë kyçe të cilat identifikojnë studimin tuaj.



- ❖ *Kujdes! Nëse ju do të paraqisni një abstrakt, ju lutem mos bëni citime në të. Nëse ju do të paraqisni një punim të plotë, citimet dhe referencat duhet të jenë në stilin APA.*

Pranimi i abstraktit apo punimit tuaj

Abstrakti/Punimi juaj do të vlerësohet nga dy rishikues (anëtarë të komitetit shkencor) në mënyrë anonime. Pas këtij procesi ju do të lajmëroheni mbi vendimin e marrë (pranim të punimit me ndryshime të domosdoshme, refuzim i punimit tuaj për shkak të mos përmbushjes së kriterëve, ose pranim i menjëhershëm pa asnjë ndryshim). Komiteti shkencor do t'ju njoftojë në vazhdimësi të këtij procesi nëse punimi juaj do të pranohet për prezantim oral apo poster duke ju udhëzuar mbi detajet e prezantimit më tej. Nëse autori i parë nuk mund të jetë prezent në kohën e caktuar për prezantim, duhet patjetër të paraqitet njeri nga bashkëautorët. Abstraktet dhe punimet do të botohen në librin e konferencës të pajisur me ISBN.

Ju lutemi sigurohuni që paraqitja juaj të përmbushë udhëzimet strikte të konferencës për pranimin e abstrakteve/punimeve shkencore.

Detaje mbi formatimin:

- ✚ Abstrakti duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe dhe angleze;
- ✚ Format i tij duhet të jetë në një faqe A4;
- ✚ Abstrakti duhet të përmbajë 300-350 fjalë;
- ✚ Shkrimi i abstraktit/punimit duhet të jetë në 12pt Times New Roman, Bold, Justify
- ✚ Hapësira mes rreshtave 1.15

- ✚ Autorët listohen sipas kontributit në punim (12 Points, Times New Roman, Bold, Centered);
- ✚ Për autorin e parë nevojiten pozicioni i punës, institucioni, e-mail;
- ✚ Titujt dhe gradat profesionale nuk duhet të jenë të përfshira;
- ✚ **Fjalët kyçe** duhet të përfshijnë 3-5 fjalë dhe të paraqiten në rend alfabetik.

Data të rëndësishme:

Dorëzimi i Abstraktit/punimi i plotë: 7 prill 2022

Njoftimi i Pranimit/Refuzimit: 14 prill 2022

Data e Konferencës: 19-20 maj 2022



CALL FOR ABSTRACTS/PAPERS

The UNIVERSITY OF ELBASAN “ALEKSANDËR XHUVANI”,
FACULTY OF TECHNICAL MEDICAL SCIENCES,
NURSING DEPARTMENT

in collaboration with the

UNIVERSITY OF VLORA “ISMAIL QEMALI”
UNIVERSITY OF SHKODRA “LUIGJ GURAKUQI”
“ALBANIAN NURSING ORDER”
UNIVERSITY OF BARI “ALDO MORO”
UNIVERSITY OF L’AQUILA

Organizes

“INCS 2022-The VIth INTERNATIONAL NURSING
CONFERENCE ON SPECIALTIES”

This conference is organized under the support of the Rector of the University of
Elbasan “Aleksandër Xhuvani”

Prof.Dr. Skënder TOPI

And,

Prof.as.dr. Shkëlqim HIDRI

Doc./Dr. Elona GAXHJA

Prof.Dr. Medi AGOLLI





The Nursing Department, Faculty of Medical Technical Sciences, University of Elbasan "Aleksander Xhuvani", in collaboration with the Scientific Research Center of Public Health, Faculty of Health, the University of Vlora "Ismail Qemali", Department of Nursing, Faculty of Natural Sciences, the University of Shkodra "Luigj Gurakuqi" the Order of Nurses of Albania, and the Department of Life, Health and Environmental Sciences, University of L'Aquila, the University of Bari "Aldo Moro", Italy, invites you to submit the abstract/papers for "**INCS 2022-THE VIth INTERNATIONAL NURSING CONFERENCE IN SPECIALTIES**" which will take place on 19-20 May 2022, at the University of Elbasan "Aleksander Xhuvani", Faculty of Medical Technical Sciences, Elbasan.

The International Council of Nurses (ICN) has announced as a theme for International Nurses Day 2022, "**Nurses: A Voice to Lead - Invest in Nursing and Respect the Rights to Global Health**", focusing on the need for protection, support, and investments in Nursing, to strengthen the health system worldwide.

Purposely, this conference aims to bring together academics, professionals, researchers, and students from all areas of health and related disciplines such as nursing education, telemedicine, infectious diseases, neonatology, surgery, emergency, pain management, psychiatry, trauma, pediatrics, geriatrics, public health, midwifery, critical care, health policy, forensics, psychology, mental health, palliative health, ethical issues, management and leadership, computer science, etc. inviting them to contribute to its development by submitting their abstracts of a research nature, papers, and posters, to present and discuss the recent innovations, trends and concerns, practical challenges encountered and possible solutions.

Researchers in the field of Nursing, Midwifery, Medicine, Laboratory Technicians, Imaging Technicians, Pharmacology, and Psychology are invited to participate and share recent scientific knowledge, perspectives, and developments in the respective fields.



Important dates:

Submission of Abstract / Full paper: April 7, 2022

Acceptance / Rejection Notice: 14 April 2022

Conference Date: 19-20 May 2022

Location: Faculty of Medical Technical Sciences, Elbasan

Preferred language: Albanian, English, Italian.

Participant's CV: All abstracts and submitted works must have attached the CV of the first author.

Contacts:

For any questions regarding the conference, please contact:	konferenca.fshmt@uniel.edu.al elona.gaxhja@uniel.edu.al
For the submission of the abstract/paper, the following addresses are available:	konferenca.fshmt@uniel.edu.al armela.kapaj@uniel.edu.al

Additional information:

To send the abstract and the full paper, communicate the participation and payment fee, or require any other necessary information, please contact us through the conference email: konferenca.fshmt@uniel.edu.al.

You will find the details for submitting your abstract/paper, as well as the acceptance process in the paragraph below.

Thank you for your interest!



ABSTRACT/PAPER SUBMISSION GUIDELINES

Abstracts/full papers must be authentic (original) and of high quality, through which are described original and unpublished results of conceptual, constructive, empirical, experimental, or theoretical research work in all fields of Nursing as well as medical sciences and health. The abstract or paper you are going to present should not have been previously presented in any journal, book with ISBN, or any other scientific activity.

Authors should submit an abstract of 300-350 words.

The details of each section of the abstract are described below:

- ✚ **Title of the abstract / paper:** It should be clear, strong, and concise. Make sure the title of your abstract describes the argument well, informing and attracting the reader about the concept to be discussed.
- ✚ **Introduction:** It is crucial to present an overview of your study as well as to underline its importance. This section can be reinforced in detail with the findings of previous studies, highlighting the creativity of your study compared to them.
- ✚ **Purpose of the study:** You must describe the purpose of your study.
- ✚ **Methods:** In this section, you should present the research methodology you used to collect your data, including descriptions of the instruments, software, or participants in the study.
- ✚ **Results:** Summarize the results of your study in detail.
- ✚ **Conclusions:** Based on your results, describe which are the conclusions of this study, by stating the theoretical or practical implications of your paper and/or describing how this paper has brought innovation.
- ✚ **Keywords** - List 3-5 keywords that identify your study.
- ❖ *Please, if you are going to submit an abstract, please do not cite it in the text. If you are going to submit a full paper, the citations and references should be in APA style.*



Acceptance of your abstract/paper

Each abstract will be reviewed by two independent reviewers (members of the scientific committee)– double-blind review. After this process, you will be notified of the decision taken (acceptance of the work with necessary changes, rejection of your abstract/paper due to non-compliance with the criteria, or immediate acceptance without any changes). The Scientific Committee will inform you in the continuation of this process if your abstract/paper will be accepted for oral presentation or poster, guiding you on the details of the further presentation. If the first author cannot be present at the time allotted for the presentation, one of the co-authors must appear. Abstracts and papers will be published in the proceeding book. *Please ensure that your presentation meets the strict conference guidelines for accepting abstracts / scientific papers.*

Formatting details:

- + The abstract must be submitted in Albanian and English.
- + Its format must be on an A4 page.
- + The abstract should contain 330-350 words.
- + Abstract writing should be in 12pt Times New Roman, Bold, Justify.
- + Space between rows 1.15.
- + Authors are listed according to their contribution (12 Points, Times New Roman, Bold, Centered).
- + The first author needs a job position, institution, email.
- + Professional titles and degrees should not be included.
- + Keywords should include 3-5 words and appear in alphabetical order.

